

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime prioritare

Nr.	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
1	Rishikimi i legjislacionit zgjedhor për të shmangur ‘gabimet’ e bëra gjatë zgjedhjeve parlamentare 2021	Progres i pamjaftueshëm	Kuvendi nuk arriti të realizonte rishikimin e legjislacionit zgjedhor, veprimtaria e Komisionit Ad hoc për reformën zgjedhore nuk arriti të jepte rezultatet e kërkuara nga OSBE/ODIHR. Kuvendi miratoi vetëm ndryshime në Kodin Zgjedhor që kushtëzoheshin prej vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me votimin nga jashtë territorit të vendit dhe shfuqizimin e herësit për shpërndarjen e mandateve midis kandidatëve të subjektit zgjedhore të kushtëzuar nga votat parapëlqyese.